

D E K R E T
Nr.13, datë 5.8.1991

PËR DHËNIE TITUJSH NDERI

Në mbështetje të nenit 28 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

U JEP:

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

TITULLIN "ARTIST I POPULLIT"

1. Stavri Nisi Shkurti
2. Thimi Filip Filipi (pas vdekjes)
3. Luftar Gani Paja

me këtë motivacion:

"Është shquar për merita të veçanta si aktor i skenës dhe i kinematografisë në krijimin e një sërë roleve të interpretuara me mjeshtri të lartë artistike dhe për ndihmesën e çmuar që ka dhënë në zhvillimin e këtyre gjinive të artit tonë kombëtar"

TITULLIN "PIKTOR I POPULLIT"

Agim Mahmut Zajmi

me këtë motivacion:

"Për veprimtari të shquar dhe me nivel të lartë artistik në fushën e arteve figurative si piktor dhe skenograf. Ka krijuar vepra që pasqyrojnë me dinjitet realitetin historik e aktual të vendit tonë, si dhe për ndihmesën e dhënë në përgatitjen e krijuesve të rinj".

TITULLIN "ARTIST I POPULLIT"

1. Pirro Kristo Suljoti
2. Lindita Kito Theodhori
3. Afërdita Iljaz Zonja

me këtë motivacion:

"Për veprimtari të gjatë e me nivel të lartë artisik si këngëtar në grupin karakteristik "Liria" të qytetit të Korçës".

4. Jorgaq Andrea Nano

me këtë motivacion:

"Për veprimtari të gjatë e me nivel të lart artistik si drejtues i gupit karakteristik "Lira" dhe për ndihmesën e dhënë në zhvillimin e veprimtarive artistike".

5. Llazi Vasil Serbo

me këtë motivacion:

"Si aktor i skenës dhe i kinematografisë është shquar për interpretim me nivel të lartë artistik të shumë roleve, duke dhënë ndihmesën e tij në zhvillimin e artit tonë skenik".

6. Kozma Dhimitër Laro

7. Shpëtim Ibrahim Kushta

me këtë motivacion:

"Për krijimtari të pasur muzikore dhe me nivel të lartë artistik, duke dhënë ndihmesë të

shquar në zhvillimin e artit muzikor".

8. Roland Lili Trebicka

me këtë motivacion:

"Si aktor i teatrit është shquar për interpretim me nivel të lartë atistik, me origjinalitet dhe fantazi të shumë roleve, duke dhënë ndihmesën e tij në zhvillimin e artit tonë skenik".

9. Ndriçim Musa Kazazi

me këtë motivacion:

"Për krijimin e ekzekutimin me nivel të lartë figuravë artistike të numrave akrobatikë të ajrit me karakter kombëtar e frymë popullore".

10. Frrok Kol Haxhia

me këtë motivacion:

"Është dalluar për krijimin e interpretimin me nivel të lartë artistik të këngëve folklorike, si dhe për ndihmesën e dhënë në vazhdimin e traditave folklorike të rrethit".

11. Fatos Jup Sela

me këtë motivacion:

"Si aktor i teatrit është shquar për interpretim me nivel të lartë artistik në shumë role, duke dhënë ndihmesën e tij në zhvillimin e artit tona skenik".

12. Todi Ndini Llupi

me këtë motivacion:

"Për krijimin e figurave me nivel të lartë artistik si aktor e parodist i estradës, duke dhënë ndihmesën e tij në zhvillimin e humorit e të estradës".

13. Teodor Serafin Rupi

me këtë motivacion:

"Për realizimin me nivel të lartë artistik të një numri të madh rolesh në teatër e kinematografi, nga dramaturgjia jonë dhe ajo përparimtare botërore".

14. Lutfi Mazllum Hoxha

me këtë motivacion:

"Për punë të palodhur e me nivel të lartë artistik në realizimin e shumë roleve në teatër e kinematografi".

15. Hajk Agop Zaharian

me këtë motivacion:

"Është shquar për krijimtari të pasur dhe me nivel të lartë artistik në fushën e muzikës e veçanërisht të muzikës së lehtë dhe të filmit".

16. Bujar Abdulla Kokonozi

me këtë motivacion:

"Për ndihmesën e shquar që ka dhënë si operator në realizimin me cilësi të lartë artistike dhe me origjinalitet të shumë filmave artistik televizivë dhe të emisioneve televizive".

TITULLIN "PIKTOR I MERITUAR"

1. Anastas Gjergj Kostandini

me këtë motivacion:

"Për krijimtari me nivel të lartë artistik në fushën e arteve figurative dhe për ndihmesën e dhënë në zhvillimin e saj".

2. Naxhi Hysan Bakalli

me këtë motivacion:

"Për krijimtari me origjinalitet e me nivel të lartë artistik në pikturë dhe për ndihmesën e vazhdueshme në edukimin e përgatitjen e talenteve të reja në fushën e arteve figurative".

3. Zamir Abdi Mati

me këtë motivacion:

"Për ndihmesën e dhënë për një periudhë shumëvjeçare në realizimin e veprave me vlerë

të lartë si piktor e grafist".

TITULLIN "SKULPTOR I JMERITUAR"

Perikli Koli Çuli
me këtë motivacion:

"Për krijimtari me nivel të lartë artistik në fushën e skulpturës monumentale për trajtimin e temave të aktualitetit dhe të historisë së lavdishme të popullit tonë".

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Ramiz Alia